



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 14.07.2025
Numër Protokolli: 4788/2025

A.nr. 977/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.977/2025, të datës 27.05.2025, të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit: Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.977/2025, të datës 27.05.2025, e parashtruar nga ankuesi G.H.

II. Shfuqizohet Njoftimi i datës 08.05.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore, ndërsa **Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 28.02.2025 me numër të Referencës RN0006895 për pozitën “Zyrtar për Statistika”, Divizioni i Statistikave të Mjedisit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

III Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **III** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi G.H (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 27.05.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.977/2025, lidhur konkursin me numër referencës RN00016895, për Grupin i Përgjithshëm i Mjedisit, për pozitë, ‘‘Zyrtar për Statistika’’, Divizioni i Statistikave të Mjedisit, me pretendimet ankimore se kam aplikuar në konkursin me referencës RN00016895, për Grupin i Përgjithshëm i Mjedisit, për pozitë, Zyrtar për Statistika’, Divizioni i Statistikave të Mjedisit dhe se pas shqyrtimit të dokumentacionit, ka vërejtur se mungon vendi i punës, gjë që e benë shpalljen në kundërshtim me nenin 15, të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e cila përcakton qartë vendin e punës, dhe se vendi i punës duhet të specifikohet qartë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 02.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Agjencia e Statistikave të Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 10.06.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova; Ankesën A.Nr. 3256/2025 të datës 27.05.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesin; Konkursi me numër referencë RN00016895, i datës 28.02.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025, dërguar përmes emailit, nga R.K për Sh.M; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 977/2025, e datës 10.06.2025; Njoftimi me numër protokolli 01-03-582, i datës 08.05.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare i nxjerr nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e ASK-së; Akt Emërimi i dates 16.05.2024, për Sh.M; Akt Emërimi i dates 11.04.2012, për B.Q; Akt Emërimi i dates 04.11.2013, për F.Sh; Akt Emërimi i dates 30.04.2013, për V.G; Akt Emërimi i dates 11.04.2012, për H.K; Vendimi me numër protokolli 01-494-2025, i datës 10.04.2025, për Themelimin e Komisionit të Pranimit; Aplikacioni i G.H, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 1349, e datës 05.11.2020, për G.H e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’; Vërtetimi i datës 12.03.2025; Certifikatë për G.H; Letër referencë për G.H; Referencë e datës 30.06.2022; Vërtetim i datës 13.09.2018; Vërtetim i datës 17.12.2014; Vetë deklaratë e G.H; Pasqyra e trustit për G.H, për periudhën nga data 20.11.2017, deri me datën 10.03.2025; Certifikatat për G.H; Lista e Aplikantëve; Aplikacioni i B.H me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 1712, e datës 21.05.2015, për B.H e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’; bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 49/18 e datës 21.08.2018, për B.H e lëshuar ‘‘Kolegji Ilira’’; Kontratë e punës e datës 26.03.2024, për B.H; ; Certifikatë për B.H; Certifikatë për B.H për vitin 2017; Certifikatë për B.H e datës 04.05.2016; Certifikatë për B.H e vitit 2014; Certifikatë për B.H e datës 19.05.2011; Kontratë për shërbime e datës 02.05.2023; Kontratë për shërbime e datës 05.09.2018; certifikatë e datës 22.03.2017; Kontratë mbi vepër e datës 26.10.2010; Kontratë e punës e dates 31.03.2023; Certifikatë e datës 13.08.2010; letër referencë e datës 12.09.2024; Certifikatat për B.H; vetë deklaram i B.H; Pasqyra e trustit për B.H, për periudhën nga data 16.11.2018, deri me datën 21.03.2025; Vërtetim i datës 27.05.2024; Kopje e letërnjoftimit për B.H; vërtetim i marrëdhënies së punës; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN7410; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN9706; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN1965; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN0172; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecësës së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas

kodit CN7457; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN7205; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN3742; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN8045; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN1159; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN0697; Formulari për Vlerësimin të Përgjithshëm të Ecëses së Kandidatit nga Komisioni i Pranimit, i datës 29.04.2025, sipas kodit CN1848; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin L.M, nga anëtari i komisionit H.K; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin A.Gj, nga anëtari i komisionit H.K; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin B.H, nga anëtari i komisionit H.K; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin A.B, nga anëtari i komisionit H.K; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin L.M, nga anëtarja e komisionit Sh.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin B.H, nga anëtarja e komisionit Sh.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin A.N, nga anëtarja e komisionit Sh.M; ; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin A.B, nga anëtarja e komisionit Sh.M; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin B.H, nga anëtari i komisionit B,Q; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin A.B, nga anëtari i komisionit B,Q; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin A.B, nga anëtari i komisionit B,Q; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin B.H, nga anëtarja e komisionit V.G; Formulari i Vlerësimit Individual të Anëtarit të Komisionit për Kandidatin në Intervistë i datës 07.05.2025, për kandidatin A.B, nga anëtari i komisionit B,Q.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Agjencia e Statistikave të Kosovës, më datë 28.02.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016895, për Grup i Përgjithshëm i Mjedisit, pozita “Zyrtar për Statistika” *klasa e pozitës Profesional 2*”, numri i kërkuar 1, në Divizionin e Statistikave, ku afati për aplikim ka qenë nga data 01.03.2025 deri më 30.03.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ankuesi.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, me datë 08.05.2025, me numër 01-03-582 ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatin fituese, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja Besnike Hoxha, është vlerësuar me gjithsejtë 97.6, pikë

Ankuesi G.H, i pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 27.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se kam aplikuar në konkursin me referencës RN00016895, për Grupin i Përgjithshëm i Mjedisit, për pozitë, Zyrtar për Statistika’, Divizioni i Statistikave të Mjedisit dhe se pas shqyrtimit të dokumentacionit, ka vërejtur se mungon vendi i punës, gjë që e benë shpalljen në kundërshtim me nenin 15, të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e cila përcakton qartë vendin e punës, dhe se vendi i punës duhet të specifikohet qartë.

Kolegji i Këshillit, fillimisht konstaton së Agjencia e Statistikave të Kosovës, me datën 28.02.2025, ka publikuar konkursin me Nr. reference RN00016895, për **Grupi i Përgjithshëm i Mjedisit**, pozita “Zyrtar për Statistika” në Divizionin e Statistikave të Mjedisit”, për të cilën pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor); Inxhinieri Mjedisi, Mjedisi; Kimi e Përgjithshme, Biologji, Ekologji, Gjeografi. Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”.*

Bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së kriteret e konkursit për pozitën “Zyrtar për Statistika, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë përcaktuara në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, numri rendor 27, ku përcaktohet se; 27. *Grupi i statistikës Matematikë, Ekonomi, Gjeografi*, si dhe në kundërshtim me *Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil*, sipas numrit rendor 1448, ku përcaktohet se; *Zyrtar për Statistika SHC-1448 Profesional 2 Grupi i statistikës Matematikë, Ekonomi, Gjeografi.*

Kolegji i Këshillit përpara se të lëshohet në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit, mori për bazë Vendimin Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku përmes pikës 1 të dispozitivit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, ndërsa sipas pikës 6 të dispozitivit të të njëjtit vendim përcaktohet fakti se vendimi në fjalë hynë në fuqi ditën e publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe për rrjedhojë u konstatua fakti se Vendimi Nr.08/226 i datës 23.10.2024 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, është publikuar në gazetën zyrtare me datë 23.10.2024, nga rrjedh se i njëjti ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024, ndërsa konkursi në fjalë është shpallur pasi ka hyrë në fuqi Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, përkatësisht më datë 28.02.2025.

Në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e aplikuara të nenit 19, si dhe nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: “19. *Kërkesat e përgjithshme formale, përfshijnë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkua për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës që janë të domosdoshme për kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësi;* 30.1. *Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike.* 30.2. *Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë.”*, konstatoi se Agjencia e Statistikave të Kosovës, shpalljen e konkursit RN00016895 të datës 28.02.2025 për pozitën “Zyrtar për Statistika” e ka shpallur në kundërshtim me Katalogun e Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, i aprovuar dhe i cili ka hyrë në fuqi me datë 23.10.2024 sipas Vendimit Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me dispozitat e cekura si më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojcën Nr.2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, pasi që pozita në fjalë” hynë në kuadër të grupimit **Grupi i Statistikave**, ndërsa sipas konkursit pozita në fjalë është përfshirë në grupin **Grupi i Përgjithshëm i Mjedisit**, dhe për rrjedhojë pozitës në fjalë i janë ndryshuar edhe kriteret e përcaktuara të kualifikimit arsimor të cilat janë të përcaktuara sipas rregullores së lartcekur dhe Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, nga rrjedh se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me

nenin 19 dhe nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Andaj, duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë, dhe meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në këtë procedurë të rekrutimit shkeljet janë evidentuar qysh me rastin e shpalljes së konkursit të datës 28.02.2025 ashtu që nuk janë përfillur kriteret e aprovuara lidhur me grupimin e pozitës, duke ndryshuar më pastaj edhe kriteret për fushën e kualifikimit arsimor për pozitën *Zyrtar për Statistika*”, duke u bazuar në dispozitat e nenit 53 dhe nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi që të anuloi konkursin e datës 28.02.2025 me numër të Referencës RN00016895 Grupi i Përgjithshëm i Mjedisit, pozita “Zyrtar për Statistika” në Divizionin e Statistikave të Mjedisit’, në Agjencinë e Statistikave të Kosovës si dhe të shfuqizoi çdo akt dhe veprim tjetër procedural që ndërlidhet me konkursin në fjalë.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se meqenëse konstatoi paligjshmërinë e aktit të shpalljes së konkursit në fjalë, nuk u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesën e datës 27.05.2025, pasi që konstatimi nëse pretendimet janë apo jo të bazuara nuk do ta ndryshonin natyrën vendimmarrëse të kësaj çështje administrative, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar vetëm për arsyet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 21 paragrafi 1 dhe nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, ku përcaktohet se: “21.1. Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës; 24.1. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.”, në rast se Vendimi i Këshillit nuk zbatohet sipas dispozitivit të përcaktuar, ndaj personit përgjegjës i përcaktuar në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi, do të merren masa përkatëse në pajtim me nenin 24 paragrafi 1 të të njëjtit ligj.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 977/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, G.H;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë e Statistikave të Kosovës;
- dhe Arkivit të KPMSHCK-së